



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ENERGJISË
DHE INDUSTRIË

DREJTORIA E POLITIKAVE DHE ZHVILLIMIT TE MINIERAVE

Nr...^{92/}

Tirane, date 04.05/2016

Drejtuar: Z. MALIQ BAZE
SHOQERIA "FLOAR" SHPK
RRUGA "KONGRESI I LUSHNJES" PALLATI 42
SHKALLA NR.4 APARTAMENTI NR.45

TIRANE

Për njoftim: Z. DAEL DERVISHI, DREJTOR EKZEKUTIV
AGJENCIA KOMBETARE E BURIMEVE NATYRORE
BULEVARDI "BAJRAM CURRI" BLLOKU "VASIL SHANTO"

TIRANE

Z.RRAPUSH TOLA, DREJTOR
REPARTI INSPEKTIM-SHPETIMIT TE MINIERAVE
RRUGA "LORD BAJRON", LAPRAKE

TIRANE

Lënda: Njoftim për fillim procedurash revokimi te lejes nr.1275 date 11.11.2008

I nderuar z. Baze,

Shoqëria "Floar" shpk është zotëruese e lejes minerare te shfrytëzimit nr.1275 date 11.11.2008 për ranorë pllakorë, ne objektin "Karkanjoz", Berat.

Nga struktura përgjegjëse AKBN me shkresën nr.10884 date 30.12.2015, protokolluar ne Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë (MEI) me nr.42 date 05.01.2016 është propozuar revokimi i lejes se shfrytëzimit nr.1275 date 11.11.2008 për ranorë pllakorë, ne objektin "Karkanjoz", Berat, për arsye se nuk është paguar garancia financiare për rehabilitimin e Mjedisit siç është përcaktuar ne nenin 31, pika 5 te ligjit nr.10304 date 15.07.2010 "Për sektorin Minerar ne Republikën e Shqipërisë" te ndryshuar, për vitin 2015-2016.

Leja juaj është dhëne me Ligjin nr.7796 date 17.02.1994 "Minerar te Shqipërisë" te ndryshuar qe është shfuqizuar me ligjin nr.10304 date 15.07.2010 "Për sektorin Minerar ne Republikën e Shqipërisë", te ndryshuar.

Sipas nenit 57 pika 2 dhe 3 te ligjit nr.10304 date 15.07.2010 "Për sektorin Minerar ne Republikën e Shqipërisë", te ndryshuar, përcaktohet shtrirja e efekteve edhe për lejet e dhëna përpara hyrjes ne fuqi te këtij ligji.

Propozimi i Agjencisë Kombëtare te Burimeve Natyrore për revokim është i mbështetur ne germën "ç" te pikës 1 te nenit 47 (neni qe përcakton shkeljet ligjore për te cilat një leje revokohet) te ligjit nr.10304 date 15.07.2010 "Për sektorin Minerar ne Republikën e Shqipërisë", te ndryshuar.

